



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
AGJENCIA KOMBËTARE E KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT

Nr. __ 61 __ Prot.

UDHËZIM

Nr. _01_, Datë_11. 04. 2017

I MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË ADMINISTRIMIT NR. 02, DATË 30.11.2017

PËR

**PROCEDURËN E PARAQITJES, SHQYRTIMIT DHE MIRATIMIT
TË PROJEKTEVE QË FINANCOHEN NË KUADRIN
E PROGRAMEVE KOMBËTARE PËR KËRKIM DHE ZHVILLIM**

Viti 2017

PËRMBAJTJA

I.	Procedura e paraqitjes, shqyrtimit dhe miratimit të një Projekti për Kërkim e Zhvillim	Faqe	3
II.	Modeli i Dokumentit të Projektit për Kërkim e Zhvillim	“	6
III.	Sqarime për plotësimin e Dokumentit të Projektit për Kërkim e Zhvillim ..“		18
IV.	Skema e Raportit të Misionit të Vlerësimit për Pranimin e Projektit	“	22

- Aneksë

I.	Modeli i Kontratës për Kryerjen e Misionit të Vlerësimit për pranimin e Projektit	“	26
II.	Modeli i Kontratës së Përgjithshme për Projekt Kërkimi dhe Zhvillimi “		27
III.	Modeli i Kontratës për Financim Vjetor	“	29
IV.	Skema e raportit vjetor për realizimin e detyrave dhe financimit të projektit për vitin në vazhdim dhe projektplanin e punës dhe financimit për vitin pasardhës	“	30
V.	Fjalor i termave	“	37



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
AGJENCIA KOMBËTARE E KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT**

Nr. __ 61 __ Prot.

UDHËZIM

Nr. _01_, Datë 11. 04. 2017

PËR

**PROCEDURËN E PARAQITJES, SHQYRTIMIT DHE MIRATIMIT
TË PROJEKTEVE QË FINANCOHEN NË KUADRIN
E PROGRAMEVE KOMBËTARE PËR KËRKIM DHE ZHVILLIM**

Në bazë të Ligjit Nr. 7893, datë 22.12.1994, "Për Shkencën dhe Zhvillimin Teknologjik", të VKM Nr. 607, datë 31.08.2016, "Për Krijimin, Përbërjen, Organizimin dhe Funksonimin e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit", (AKKSHI), dhe në bazë të VKM Nr. 567, datë 23.10.1995, "Për shpërblimin e Këshillave, Komisioneve dhe Ekspertizave të Veprimtarisë Shkencore e Teknologjike", Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit

UDHËZON:

1. Personat juridikë shtetërorë dhe privatë kanë të drejtë të propozojnë projekte për kërkim e zhvillim, që financohen në kuadrin e Programeve Kombëtare të Kërkimit e Zhvillimit.
2. Projektet e propozuara duhet të mbështesin dhe të synojnë arritjen e objektivave të kërkimeve shkencore e teknologjike të parashtruara në programet kombëtare për kërkim e zhvillim.
3. Procedura e paraqitjes dhe pranimit të projekt-propozimeve për kërkim e zhvillim kalon përmes këtyre hapave:
 - A. Paraqitja e kërkesës.
 - B. Kontrolli formal.
 - C. Vlerësimi i komisioneve të ekspertëve.
 - D. Marrja e vendimit.
 - E. Lidhja e kontratës.

A. Paraqitja e Kërkesës

Kërkesa e institucionit shkencor për financim në kuadrin e Programeve Kombëtare për Kërkim e Zhvillim i paraqitet organit që administron Programin Kombëtar për Kërkim e Zhvillim, në kuadrin e të cilit kërkohet financim, në formën e një projekt-propozimi. Projekt-propozimi duhet të hartohet në përputhje me kërkesat e Modelit të Dokumentit të Projektit për Kërkim e Zhvillim (Pjesa II). Projekt-propozimi paraqitet në tre kopje.

B. Kontrolli Formal

Në Agjencinë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, kontrolli formal bëhet në Drejtorinë e Programeve Kombëtare, në Sektorin e Programeve Kombëtare, që administron Programet Kombëtare për Kërkim e Zhvillim. Ai *synon* të vlerësojë nëse projekt-propozimi është formuluar në përputhje me Modelin e Dokumentit të Projektit për Kërkim dhe Zhvillim, si dhe nëse në të janë specifikuar drejt Programi Kombëtar për Kërkim e Zhvillim (PKKZH) dhe objektivat e tij të cilave u referohet. Në rast se nuk i përmbush kërkesat e lartpërmendura, projekt-propozimi kthehet për t'u plotësuar.

Plotësimet dhe korrigjimet e nevojshme bëhen brenda 15 ditëve nga data e paraqitjes së projekt-propozimit.

C. Vlerësimi i Komisioneve të Ekspertëve

Projekt-propozimi që kalon kontrollin formal i jepet për ekspertizë Komisionit të Ekspertëve, që bën *vlerësimin përmbajtësor* të tij.

Komisioni i ekspertëve për kryerjen e misionit të vlerësimit për pranimin e projekt-propozimeve, propozohet nga Drejtori i Përgjithshëm i AKKSHI-t në bashkëpunim me Drejtorinë që administron PKKZH dhe miratohet nga Bordi i Administrimit i AKKSHI-t. Pjestarë të tij zgjidhen nga specialistë të fushave përkatëse që nuk janë pjestarë të personelit të projektit ose të organeve vendimmarrëse të institucioneve që e kanë propozuar atë.

Pasi bën vlerësimin e projekt-propozimit, Komisioni i Ekspertëve paraqet raportin e misionit të vlerësimit për pranimin e tij, sipas skemës bashkëlidhur në Pjesën IV të këtij Udhëzimi.

Projekt-propozimet që vlerësohen pozitivisht nga Komisionit i Ekspertëve marrin dhe mendimin e këtij Komisioni kryesisht për prioritetet që duhen zbatuar në financimin e projekteve dhe vlerën e financimit të secilit prej tyre, nisur nga rëndësia shkencore, pesha që ai ka në arritjen e objektivave të PKKZH dhe fondet e vëna në dispozicion të programit përkatës.

Komisioni i Ekspertëve shpërblehet për punën e kryer me vlerën e plotë të ditëve të punës të pagës për titullin “Prof.” të specifikuara në kontratën e lidhur në mes palëve, që formulohet sipas modelit në Aneks I.

D. Marrja e Vendimit

Vlerësimet e Komisionit të Ekspertëve i paraqiten Drejtorit të Përgjithshëm të AKKSHI-t, i cili pasi e miraton në Bordin e Administrimit, merr vendimin përfundimtar.

E. Lidhja e Kontratës

Nëse projekt-propozimi miratohet për financim, lidhet kontrata sipas modelit bashkëlidhur (Aneks II) ndërmjet Drejtorit të Përgjithshëm të AKKSHI-t dhe institucionit shkencor që ka paraqitur kërkesën, të përfaqësuar nga drejtuesi i tij dhe drejtuesi i projektit.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

GERON KAMBERI

II. Modeli i Dokumentit të Projektit për Kërkim e Zhvillim

Emërtimi dhe adresa e institucionit që administron Programin Kombëtar për Kërkim e Zhvillim:

AGJENCIA KOMBËTARE E KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT

Tel.:

Fax:

E-mail:

<p>1. Emërtimi i institucionit kontraktues (Agjencisë Ekzekutive):</p> <p>A. Nëndarja ku do të realizohet projekti:</p>	<p>Adresa:</p> <p>Tel. :</p> <p>Fax :</p> <p>E-mail:</p>
<p>2. Institucionet që bashkëpunojnë:</p>	<p>Adresa:</p>

3. Titulli i Projektit:

A. Propozuar si pjesë e Programit Kombëtar për Kërkim e Zhvillim (PKKZH):

(Emërtimi i Programit Kombëtar: Për shembull: Programi Kombëtar “Shëndetësia”)

B. A keni qenë fitues/pjesë e grupit të punës në projekte të mëparshme të Agjencisë në kuadër të Programeve të Kërkimit dhe Zhvillimit për vitet 2010-2014.

PO

Jo

(Nese po specifikoni titullin e projektit dhe programin në të cilin ka qenë pjesë)

C. Objektivat e Programit të cilave u referohet Projekti:

(Sipas Dokumentit të Programit të përmendur në pikën „A“)

4. Afati:

Kohëzgjatja në muaj:

5. *Personeli i Projektit:*

A. *Drejtuessi i Grupit Kërkimor:*

Emri: Mbiemri: Datëlindja: Posti që mban:

Grada Shkencore:

Eksperienca në punë kërkimore:

Punimet shkencore të bëra 5 vitet e fundit:

B. *Bashkëpunëtorët shkencorë:*

Emri: Mbiemri: Datëlindja: Posti që mban:

Grada Shkencore:

Eksperienca në punë kërkimore:

Punimet shkencore të bëra 5 vitet e fundit:

Emri: Mbiemri: Datëlindja: Posti që mban:

Grada Shkencore:

Eksperienca në punë kërkimore:

Punimet shkencore të bëra 5 vitet e fundit:

Emri: Mbiemri: Datëlindja: Posti që mban:

Grada Shkencore:

Eksperienca në punë kërkimore:

Punimet shkencore të bëra 5 vitet e fundit:

(Nëse kjo faqe nuk mjafton shtoni fletë tjetër)

C. Personeli tjetër

Nr.	Emri	Profesioni dhe kategoria e pagës
1.		
2.		
3.		
4.		

6. *Argumentimi shkencor i Projektit.* (Nëse vendi më poshtë është i pamjaftueshëm, shtoni fletë tjetër. Kjo vlen edhe për pikat që vijojnë më tej).

A. Identifikimi i problemit dhe rëndësia e zgjidhjes së tij:

B. Punime të kryera deri tani ose që janë në proces në këtë fushë në institucione të tjera (brenda apo jashtë kuadrit të Programeve Kombëtare të Kërkimit e Zhvillimit):

C. Punime të kryera deri tani ose që janë në proces në këtë fushë në institucionin tuaj (brenda apo jashtë kuadrit të Programeve Kombëtare të Kërkimit e Zhvillimit):

D. Referime kryesore të literaturës në lidhje me problemin:

7. Objektivat e projektit

A. Objektivi i zhvillimit:

B. Objektivat imediate dhe rezultatet e pritshme:

Objektivi 1:

Rezultati 1:

Rezultati 2:

etj.

Objektivi 2:

Rezultati 1:

Rezultati 2:

etj.

Objektivi 3:

Rezultati 1:

Rezultati 2:

etj.

etj.

C. Lidhja e këtyre objektivave dhe rezultateve me projekte të tjera të ngjashme në institucionin tuaj e jashtë tij.

D. Kontributet specifike që sjell projekti në shkencat fundamentale dhe/ose të aplikuara (përfshirë patenta, etj.).

D.1 Me cilin prioritet strategjik Sektorial lidhet projekt-propozimi juaj?

E. Përfituesit nga projekti:

1. Përfituesit direktë:

2. Përfituesit indirektë:

3. Si mendohet t'iu bëhen të njohura rezultatet e projektit përdoruesve të mundshëm të tyre?

4. Cilat janë mundësitë që rezultatet e projektit tuaj kërkimor në fushën e përcaktuar të shndërrohet në një biznes start-up apo të patentohen?

F. Plani i përgjithshëm i punës dhe ai i detajuar për vitin e parë, përfshirë metodologjinë dhe teknikat që propozohet të përdoren:

1. Plani i përgjithshëm:

2. Plani i detajuar për vitin e parë:

8. Lista e mjeteve dhe e materialeve kryesore që do të përdoren për realizimin e projektit.
- A. Lista e mjeteve (ndërtesa, pajisje - përfshire tipin) dhe e materialeve kryesore që disponohen.

B. Lista e plotë e pajisjeve dhe e materialeve kryesore që kërkohet të blihen.

Nr.	Emërtimi	Tipi	Sasia	Njësia	Vlerësimi i shpenzimeve në Mijë Lekë
<i>Pajisje</i>					
1.					
2.					
3.					
4.					
5.					
6.					
7.					
8.					
9.					
10.					
11.					
12.					
13.					
14.					
15.					
Totali i Pjesshëm:					
<i>Materiale Kryesore</i>					
1.					
2.					
3.					
Totali i Pjesshëm:					

Totali i Plotë (Pajisje + Materiale):

9. Buxheti. Vlerësimi i projektit për vitin e parë në Mijë Lekë.

Studime fizibiliteti (Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara)

A. Honorare për përgatitje projekti dhe për studimin që do të kryhet

Personeli i Projektit dhe përqindja e kohës së plotë të punës që do të angazhohet në Projekt			Vlerësimi i shpenzimeve në Mijë Lekë	
Nr.	Emri	Koha në %	Paga Bazë dhe Shtesat	Gjithsej
1.				
2.				
3.				
4.				
5.				
Gjithsej:				

Totali i pjesshëm (A) në Mijë Lekë :

B.1. Shërbime nga të tretët (për nevojat e studimit të fizibilitetit)

Nr.	Emërtimi	Vlerësimi i shpenzimeve në Mijë Lekë
1.		
2.		
3.		
4.		
5.		

Totali i pjesshëm në Mijë Lekë :

B.2. Shpenzime Transporti (për nevojat e studimit të fizibilitetit)

Nr.	Emërtimi	Vlerësimi i shpenzimeve në Mijë Lekë
1.		
2.		
3.		
4.		
5.		

Totali i pjesshëm në Mijë Lekë :

B.3. Shpenzime udhëtimi (për nevojat e studimit të fizibilitetit)

Nr.	Emërtimi	Vlerësimi i shpenzimeve në Mijë Lekë
1.		
2.		
3.		
4.		
5.		

Totali i pjesshëm në Mijë Lekë :

B.4. Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme (për nevojat e studimit të fizibilitetit)

Nr.	Emërtimi	Vlerësimi i shpenzimeve në Mijë Lekë
1.		
2.		
3.		
4.		
5.		

Totali i pjesshëm në Mijë Lekë :

B.5. Shpenzime të tjera operative (për nevojat e studimit të fizibilitetit)

Nr.	Emërtimi	Vlerësimi i shpenzimeve në Mijë Lekë
1.		
2.		
3.		
4.		
5.		

Totali i pjesshëm në Mijë Lekë :

C. Shpenzime për ritjen e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara

C.1. Shpenzime për pajisje specifike

G. Shpenzime Kapitale

Nr.	Emërtimi	Tipi	Sasia	Njësia	Vlerësimi i shpenzimeve në Mijë Lekë
<i>Pajisje Profesionale</i>					
1.					
2.					
3.					
...					
14.					
15.					
<i>Të tjera</i>					
1.					
2.					
...					
6.					
7.					

Totali i pjesshëm në Mijë Lekë:

Vlera e plotë e projektit për vitin e parë, në Mijë Lekë :

I. Burimet e Financimit të Projektit për vitin e parë të shprehura në %.

Burimet e Financimit	%	në Mijë Lekë
Shuma që do të financohet nga vetë Agjencia Ekzekutuese dhe bashkëpunorët		
Shuma që do të financohet nga burime të tjera		
Shuma që kërkohet të financohet nga PKKZH		
Gjithsej	100%	

10. Nëse Projekti zgjat më shumë se një vit, jepet vlerësimi për fondet që kërkohen për çdo vit (duke përfshirë edhe vitin e parë) në Mijë Lekë :

Viti i financ	Honorar e studimi (zëri 230)	Shpenz. Udhët. (zëri 230)	Shërb. të tretët (zëri 230)	Shpenz. Transp. (zëri 230)	Shpenz. Të tjera operat. (zëri 230)	Totali (zëri 230)	Pajisje (zëri 231)	Gjithsej	Kërk. Nga PKKZH
Gjithsej :									

11. A është institucioni (Agjencia Ekzekutuese) person juridik?

Po/Jo

12. Kur është i përgatitur institucioni të fillojë Projektin?

13. Cilat janë risqet e mundëshme dhe si do të kapërcehen?

Drejtuesi i Grupit Kërkimor

Drejtuesi i Agjencisë Ekzekutuese

Firma

Data :

Firma

Data :

III. Sqarime për plotësimin e Dokumentit të Projektit për Kërkim dhe Zhvillim

Plotësimi i saktë i Dokumentit të Projektit sipas kërkesave të Modelit të dhënë më sipër ka rëndësi të veçantë, sepse mbi këtë dokument bazohet zgjedhja ose refuzimi i projekt-propozimit për financim. Në plotësimin e tij të mbahet parasysh sa vijon:

- Në krye të Dokumentit shënohet emri i plotë i ministrisë ose i institucionit qendror, si dhe i drejtorisë përkatëse të tij, që administron PKKZH në kuadrin e të cilit kërkohet financim për projektin e paraqitur. Jepet adresa e plotë e institucionit qendror si dhe numri i telefonit, fax-it dhe e-mail i drejtorisë përkatëse që administron PKKZH.
- Pika 1 - Shënohet instituti, fakulteti apo qendra shkencore, shtetërore apo private, që njihet si person juridik dhe që merr përsipër të gjitha detyrimet për realizimin në kohë e me cilësi të projektit (Agjencia Ekzekutuese). Shënohet, gjithashtu, nënndarja e saj (departamenti, sektori, kabineti, etj.) që do të realizojë apo do të drejtojë projektin.
- Pika 2 - Shënohen të gjitha institucionet që do të bashkëpunojnë për realizimin e projektit, me të cilët Agjencia Ekzekutuese ka nënshkruar marrëveshje, para paraqitjes së projekt-propozimit në institucionin qendror të ngarkuar me administrimin e PKKZH përkatës.
- Pika 3 - Jepet titulli i projektit, i cili duhet të shprehë në mënyrë sintetike objektin e studimit (jo më shumë se 200 karaktere).
 - Në pikën 3/A jepet titulli i plotë dhe afati i PKKZH në kuadrin e të cilit kërkohet financim.
 - Në pikën 3/B duhet të jepni nëse keni qenë më parë pjesë e një projekti PKKZH 2010 – 2014.
 - Në pikën 3/C jepen objektivat e këtij PKKZH që mbështet projekti, duke ju referuar numrit rendor të tyre në dokumentin e PKKZH ose duke i cituar ato të plota sipas formulimit të tyre në dokumentin e PKKZH.
- Pika 4 - Jepet afati i realizimit të projektit, duke shënuar kohën e fillimit (muaji, viti) dhe të përfundimit të tij (muaji, viti). Koha e përfundimit përfshin shqyrtimin dhe miratimin e projektit në Këshillin Shkencor të Agjencisë Ekzekutuese dhe paraqitjen e raportit shkencor përfundimtar në Agjencinë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit që administron PKKZH. Jepet gjithashtu kohëzgjatja e projektit në muaj.
- Pika 5 - Jepet përbërja e grupit kërkimor që do të realizojë projektin, duke përfshirë edhe kërkuesit e institucioneve bashkëpunëtoare. Drejtuesi i grupit kërkimor duhet të jetë një dhe i vetëm.
 - Pikat 5/A&B - Jepen eksperiencia në punë kërkimore e shprehur në vite, si dhe drejtimet kryesore të kërkimeve në të cilat ka qenë i angazhuar drejtuesi i grupit kërkimor dhe secili bashkëpunëtor shkencor i këtij grupi, duke theksuar në rradhë të parë ato drejtime të kërkimeve që lidhen me projektin e propozuar si dhe përgjegjësitë e mëparëshme si kërkues (drejtues, kërkues, etj.). Në punimet shkencore të bëra 5 vitet e fundit të përfshihen libra, artikuj, studime shkencore e raporte teknike të botuara ose të arkivuara nga kërkuesi, duke dhënë titullin, shtëpinë botuese të librit ose periodikut ose institucionin shkencor në arkivin e të cilit është depozituar materiali, si dhe vitin e botimit apo depozitimit. Në këtë prezantim punimesh, përparësi ti jepet atyre që kanë lidhje me objektin e kërkimit të projektit.
 - Pika 5/C - Jepet personeli ndihmës i projektit, ku përfshihen punonjës të ndryshëm, veç personelit kryesor, të nevojshëm për kryerjen e analizave, eksperimenteve apo matjeve fushore, ndërtimin e modeleve apo prodhimin e pajisjeve specifike, etj..

- Pika 6 - Sqarohen arsyet e ndërmarrjes së studimit dhe bëhet argumentimi i plotë dhe i qartë i rëndësisë së zgjidhjes së tij për zhvillimin shkencor, teknologjik dhe ekonomik-shoqëror të vendit.
- Pika 6/A - Bëhet identifikimi i problemit dhe argumentohet rëndësia e zgjidhjes së tij. Në këtë kuadër duhet të sqarohen çështje të tilla si:
 - ◆ gjendja e deritanishme ose njohja e problemit para ndërmarrjes së projektit;
 - ◆ arsyet përse ndërmerret projekti dhe çfarë synohet të zgjidhet në kuadër të tij;
 - ◆ alternativat e zgjidhjes së problemit;
 - ◆ të rejat që pritet të sjellë projekti në planin shkencor dhe/ose teknologjik;
 - ◆ ndikimi ekonomik, social, ekologjik, etj., i zgjidhjes së problemit;
 - ◆ a janë të komercializueshme rezultatet e pritshme të projektit;
 - ◆ a ekzistojnë aktualisht mundësitë materiale dhe njerëzore për realizimin e plotë dhe zbatimin e rezultateve të tij;
 - ◆ a është e domosdoshme që projekti të ndërmerret në këtë moment;
 - ◆ përveç institucionit që ndërmerr studimin, kujt tjetër i interesojnë rezultatet e pritshme të projektit për zbatim;
 - ◆ përse projekti duhet të financohet nga buxheti i shtetit, etj..
- Pika 6/B - Jepen punimet shkencore të kryera deri tani në këtë fushë ose që janë në proces nga institucione të tjera shkencore brenda ose jashtë kuadrit të PKKZH, si dhe lidhja që ato kanë me projektin që do të ndërmerret, me qëllim që të shmanget përsëritja ose kryerja e punëve paralele.
- Pika 6/C - Jepen punimet shkencore të kryera ose që janë në proces në këtë fushë nga njësi të tjera (grupe kërkimore, sektorë, etj.) në vetë Agjencinë Ekzekutive brenda ose jashtë kuadrit të PKKZH, që kanë lidhje me projektin që do të realizohet, me qëllim që të shmangen paralelizmat dhe njëkohësisht të shfrytëzohen rezultatet e tyre.
- Pika 7:
 - Pika 7/A - Jepet *objektivi i zhvillimit* të projektit, që shpreh një pikësynim të rëndësishëm në lidhje me zhvillimin e kërkimeve në fushën përkatëse, sipas formulimit të bërë në Programin Kombëtar për Kërkim dhe Zhvillim. Projekti vetë mund të mos e arrijë këtë objektiv, i cili mund të realizohet në kompleks me projekte të tjera, por ai merr përsipër të luajë një rol në këtë kuadër të përgjithshëm zhvillimi.
 - Pika 7/B - Jepen *objektivat imediate* që përbëjnë synimet thelbësore të projektit. Ato duhet të formulohen si qëllime, të jenë të shprehura në mënyrë konçize dhe të saktë, duke vënë në dukje progresin që do të arrihet në krahasim me gjendjen para projektit (të parashtruar në pikën 6 të Dokumentit të Projektit). Duhet të mënjanojnë objektivat imediate me karakter të përgjithshëm. Objektivat imediate duhet të jenë konkrete. Arritja e tyre duhet të shprehet me rezultate të matshme e të kontrollueshme, që mund të arrihen me aktivitete brenda mundësive të financimit, kohës, forcave njerëzore e materiale të disponueshme. Për çdo objektiv imediat të jepen rezultatet e pritshme që justifikojnë arritjen e tij. Çdo objektiv mund të ketë një ose disa rezultate. Rezultati duhet të shprehet me terma të qarta e të jetë i matshëm. Mundet që një rezultat të mbështesë më shumë se një objektiv.
 - Pika 7/C - Pasqyrohet raporti i objektivave imediate dhe i rezultateve të pritshme të projektit me ato të projekteve të tjera të kësaj fushe që zhvillohen në institucionet e përfshira në projekt ose jashtë tyre.
 - Pika 7/D - Jepen përmbledhtazi kontributet *specifike* që pritet të sjellë projekti në shkencat fundamentale dhe/ose të aplikuara, përfshirë patenta, etj.. Ky

- informacion do të jetë nga më të rëndësishmit për të gjykuar për pranimin apo refuzimin e projektit.
- Pika 7/E - Jepen *përfituesit* nga projekti, që ndahen në *direkt* dhe *indirekt*. Përfituesit direkt janë ata që mbështeten direkt nga fondet e projektit, ndërsa përfituesit indirektë janë ata që mund të përfitojnë nga rezultatet e zbatimit të projektit. Jepen gjithashtu rrugët që mendohet të ndiqen për t'i bërë të njohura rezultatet e projektit për të gjithë përdoruesit e mundshëm të tyre – botime shkencore, seminare, vidiokaseta, fletë palosje, reklama komerciale, etj.. Aktivitetet kryesore që lidhen me to dhe që mendohet të zhvillohen brenda afatit të projektit, duhet të parashikohen në planet e punës (shih pika 7/F).
 - Pika 7/F - Jepet plani i përgjithshëm i punës i ndarë në vite, ndërsa për vitin e parë jepet plani i detajuar. Në këto plane pasqyrohen aktivitetet që do të kryhen për të arritur rezultatet e kërkuara dhe, për rrjedhojë, objektivat imediate të parashikuara. Çdo rezultat duhet të mbështetet të paktën nga një aktivitet. Gjatë përshkrimit të aktiviteteve duhet të jepen edhe metodat e teknikat kryesore që do të aplikohen për realizimin e tyre. Për çdo aktivitet përcaktohet kohëzgjatja (muaj, javë, etj.) dhe tregohet se kush përgjigjet për realizimin e tij. Në planin e punës përfshihen dhe kualifikimet e nevojshme, konsultimet, shkëmbim ekspertësh, etj., që i shërbejnë realizimit të pjesëve të veçanta apo projektit në tërësi. Nuk është e nevojshme që në këto plane të paraqiten çështje të rutinës administrative.
- Pika 8 – Gjatë hartimit të listës së mjeteve dhe materialeve (genetike bimore ose shtazore, radioaktive, minerare, etj.) që disponohen dhe që do të përdoren për realizimin e projektit, jepen vetëm ato më kryesoret, që disponohen nga Agjencia Ekzekutuese dhe institucionet bashkëpunëtoare (nënpika A). Të gjitha pajisjet dhe materialet e nevojshme për realizimin e projektit, që kërkohet të blihen me fondet e tij, kur vlera e tyre është më e madhe se 10000 lekë, specifikohen në nënpikën B. Pajisjet dhe materialet e kërkuara duhet të kenë lidhje direkte me objektivat e projektit, si dhe me aktivitetet, metodologjinë dhe teknikat eksperimentale të parashikuara në planin e përgjithshëm dhe/ose vjetor të tij. (shih pikat 7B, F/1&2)
 - Pika 9 - Paraqitet ndarja e fondeve (shpenzimeve) sipas zërave të veçantë të tabelës bashkëngjitur mbi përdorimin unik të artikujve të klasifikimit buxhetor ku:
 - Në artikullin **230** “*Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të pa trupëzuara*”, këtu përfshihen:
 1. Studime fizibiliteti
 2. Të tjera (ato që nuk përfshihen në “Studime fizibiliteti”)
 - Në artikullin **231** “*Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara*”, këtu përfshihen
 - “Shpenzime për instalimin e rrjetit kompjuterik”, këtu përfshihen blerja dhe instalimi i rrjetit kompjuterik.
 - “Shpenzime për aparatet, pajisjet teknike dhe vegla pune (blerja e aparaturave, pajisje teknike dhe veglave të punës për realizimin e aktivitetit për llogari të të tretëve), etj
- Pika 10 - Nëse Projekti zgjat më shumë se një vit, jepet vlerësimi për fondet që kërkohen për çdo vit dhe totali i pjesshëm për çdo artikull, si dhe totali i plotë për të gjithë projektin.
 - Pika 13 - Pasqyrohen të gjitha risqet që mund të rrezikojnë realizimin në afat dhe me cilësinë e kërkuar të projektit dhe jepen shpjegime për mënyrën e kapërcimit të tyre.

IV. Skema e Raportit të Misionit të Vlerësimit për Pranimin e Projektit

AGJENCIA KOMBËTARE E KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT

Titulli i Projektit:

Numri (Kodi) i Projektit:

Raport i Misionit të Vlerësimit për Pranimin e Projektit

Grupi i Misionit të Vlerësimit
(Titulli dhe/ose Grada, Emri, Mbiemri, Firma)

Data:

1. _____
2. _____
3. _____

Skema e Raportit të Misionit të Vlerësimit për Pranimin e Projektit

A. Konceptimi dhe shtjellimi në tërësi i Projektit

- A mbështetet konceptimi i projektit në një analizë të thelluar të problemeve të fushës përkatëse të kërkimeve dhe a është identifikuar mirë problemi që do të zgjidhet?
- A është ky problem specifik për ne apo kërkohet zgjidhje specifike (origjinale për kushtet tona) e një problemi të përgjithshëm e të njohur?
- A është skicuar strategjia e projektit (rrugët që do të ndiqen) mbi bazën e analizës së alternativave të zgjidhjes së problemit? A mbështetet ajo në një analizë paraprake të kostos së tyre (qoftë dhe të thjeshtuar)?
- A janë specifikuar drejt supozimet kryesore mbi të cilat mbështetet trajtimi dhe zgjidhja e problemit të shtruar ? (shih pikat 6/A, B, C, D)
- A është i përshtatshëm titulli i zgjedhur i projektit? (shih pikën 3)
- A janë formuluar drejt objektivi i zhvillimit, objektivat imediate dhe rezultatet e pritshme? (shih pikat 7/A, B)
- A është specifikuar drejt programi i kërkimeve në kuadrin e të cilit propozohet projekti? (shih pikën 3A).
- A janë në pajtueshmëri objektivat e projektit me objektivat e PKKZH të fushës përkatëse? Cilat objektiva konkrete të këtij Programi mbështeten nga ky projekt? (shih pikat 3B; 7/A, B; si dhe Programin).
- A janë specifikuar dhe a gjykohen me vend kontributet specifike që sjell projekti në shkencat fundamentale dhe/ose të aplikuara (përfshirë patenta, etj.)? (shih pikën 7D)
- A janë parashikuar teknikat dhe metodat më të përshtatshme për studimin e problemit? Çfarë teknikash dhe metodash të tjera, të mundshme për tu realizuar në kuadrin e projektit, do të sugjeronit dhe si e argumentoni nevojën e tyre? (shih pikën 7F)
- A janë specifikuar drejt dhe a janë bindëse risqet e mundshme? (shih pikën 13)
- A është vlerësuar drejt mundësia e komercializimit të rezultateve të projektit? (shih pikën 6A)
- A janë identifikuar qartë përfituesit nga projekti: ata direkt (që përfitojnë drejtpërdrejt nga projekti) dhe ata indirektë (që përfitojnë prej rezultateve të tij)? A janë specifikuar dhe a janë bindëse dhe/ose të mjaftueshme aktivitetet e parashikuara për t'ua bërë të njohura rezultatet e projektit përdoruesve të mundshëm të tyre? (shih pikën 7E dhe 7F/1&2)

B. Rregullimi institucional dhe personeli i projektit

- A janë specifikuar institucionet kryesore bashkëpunëtoresh në projekt? A ju duket i përshtatshëm rregullimi i propozuar institucional? Çfarë plotësime e përmirësime të mëtejshme mund të bëheshin në këtë drejtim? (shih pikën 2)
1. A ekzistojnë mundësi bashkëpunimi ndërkombëtar dy ose shumëpalësh të njohura nga ju për trajtimin dhe zgjidhjen e këtij problemi? Çfarë do të sugjeronit ju?
 2. A është i mjaftueshëm informacioni i dhënë mbi personelin e projektit në projekt-dokument?

3. A ju duket e përshtatshme përbërja profesionale e personelit të projektit dhe në ç'drejtime ka vend për plotësime apo përmirësime të mëtejshme?
4. Cili është opinioni juaj mbi aftësitë e personelit të propozuar të projektit ? A mund ta çojë ai deri në fund me sukses projektin? (shih pikën 5)
5. A janë të drejta kërkesat e parashtruara në projekt-dokument në lidhje me marrjen e përvojës jashtë shtetit (kualifikime afatshkurtra, seminare, konferenca shkencore, etj.) në kuadrin e projektit dhe në ndihmë të tij? Çfarë do të sugjeronit ju? (shih pikat 7F/1,2)

C. Afati i projektit dhe monitorimi i tij

1. A dalin qartë të verifikueshme në kohë, në kuadrin e planit të përgjithshëm të zbatimit të projektit, objektivat kërkimore të tij?
2. A janë parashikuar dhe konceptuar drejt ndarja e fazave të projektit dhe radha dhe shtrirja kohore e aktiviteteve kryesore të tij në planin e përgjithshëm të projektit? A sigurojnë ato arritjen në kohë të objektivave dhe të rezultateve të parashikuara? (shih pikat 7B e 7F/1,2)
3. A është i justifikuar afati i parashikuar i zgjatjes së projektit? Cili është sugjerimi juaj në lidhje me këtë dhe si e argumentoni? (shih pikat 7B, 7F/1 dhe 4)
4. Çfarë do të sugjeronit në lidhje me mekanizmin e monitorimit të projektit, veç atyre që parashikohen në projekt-dokument?

D. Vlerësimi i komponenteve materiale e financiare të inpleteve të projektit

(Shih pikat 8 e 9 të projekt-dokumentit)

1. A janë të justifikueshme teknikisht kërkesat e bëra në kuadrin e projektit për blerje pajisje e materiale dhe për shpenzime të tjera si udhëtime, transport, etj.?
2. A është i saktë vlerësimi i bërë për zërat e buxhetit?
A e konsideroni të drejtë strukturën e burimeve të financimit të projektit? Mendoni se Agjencia Ekzekutive e ka ezauruar plotësisht mundësitë për financim të projektit, qoftë dhe pjesërisht nga buxheti i saj dhe ka eksploruar si duhet mundësitë për financim nga burime të tjera jashtë PKKZH? Cili është sugjerimi juaj në lidhje me këtë çështje dhe si e argumentoni?

E. Konstatimet dhe sugjerimet më të rëndësishme

Cilat janë konstatimet më të rëndësishme të misionit të vlerësimit?

Cilat janë sugjerimet më të rëndësishme në lidhje me mundësinë e përmirësimit të dokumentit të projektit?

F. Konkluzioni përfundimtar në lidhje me pranimin ose jo të projektit.

Jepet në mënyrë eksplicite dhe të pakushtëzuar mendimi për pranimin ose jo të projektit.

K O N T R A T Ë

Nr. ____ Prot

Tiranë, më/...../.....

PËR KRYERJEN E MISIONIT TË VLERËSIMIT PËR PRANIM PROJEKTI

Sot më datë lidhet kjo kontratë ndërmjet:

Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI), institucion financues, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm.....

dhe Eksperti i Komisionit të Vlerësimit , _____, për:

“Kryerjen e vlerësimit përmbajtësor për pranim të projekt-propozimeve të paraqitura pranë Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit që kërkohen të financohen në kuadër të Thirrjes për Aplikim me projekte në Programet Kombëtare të Kërkimit dhe Zhvillimit, datë/...../.....

duke iu përmbajtur kushteve të mëposhtme:

- I. Para nënshkrimit të kësaj Kontrate vlerësuesi duhet të jetë dakord e të firmosë “Deklaratën mbi Konfliktin e Interesit”, (bashkangjitur kësaj kontrate) bazuar në **Udhëzimin Nr. 01, datë 11.04.2017** të Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit për “Procedurën e paraqitjes, shqyrtimit dhe miratimit të projekteve që financohen në kuadrin e Programeve Kombëtare të Kërkimit dhe Zhvillimit”, pika 3c, i cili thekson se :
“Pjesëtarë të grupit të Komisioneve të Ekspertëve të Vlerësimit zgjidhen nga specialistë të fushave përkatëse që nuk janë pjesëtarë të personelit të projektit ose të organeve vendimmarrëse të institucioneve që e kanë propozuar atë”.
- II. Ekspertët do të kryejnë vlerësimin duke plotësuar të gjitha rubrikat e “Skedës së Raportit të Misionit të Vlerësimit të projekt – propozimit”. Pasi bën vlerësimin e projekt-propozimit, komisioni i ekspertëve paraqet raportin e vlerësimit për pranimin apo refuzimin e tij sipas skedës të ekspertëve të vlerësimit e cila u vihet në dispozicion ekspertëve nga specialistët e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit.
- III. Komisioni i Ekspertëve shpërblehet për punën e kryer bazuar në VKM Nr. 567, datë 23.10.1995, “Për shpërblimin e Këshillave, Komisioneve dhe Ekspertizave të Veprimtarisë Shkencore e Teknologjike”.

- IV.** Ekspertët do të dorëzojnë ekspertizën brenda datës së caktuar nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit.
- V.** Në rast mos respektim të datës së dorëzimit të ekspertizës organi financues mund të marrë këto sanksione:
 - a. Pagesë të pjesshme të ekspertit.
 - b. Mos pagesë të ekspertit.
 - c. Mos aktivizim të ekspertit në ekspertiza të ardhshme.

Kontrata u përgatit në tre kopje (dy për organin financues dhe një për ekspertin).

Palët pasi e lexuan dhe e gjetën kontratën konform ligjit dhe interesave të tyre, e nënshkruan atë.

EKSPERTI I VLERËSIMIT

PËRFAQËSUESI I ORGANIT FINANCUES

GERON KAMBERI

K O N T R A T Ë

Nr. _____ Prot

Tiranë, më/...../.....

E PËRGJITHËSHME PËR PROJEKT KËRKIMI DHE ZHVILLIMI*

Sot, më datë, në Tiranë, ndërmjet:

Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI), institucion financues, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm.....,

dhe (Emri i Institucionit, Agjencisë Ekzekutuese) përfaqësuar nga:

.....
lidhet kontrata me kushtet që vijojnë:

1. Dokumenti i Projektit për Kërkim dhe Zhvillim me titull:

.....
.....
.....
.....,

i paraqitur për financim në kuadrin e Programit Kombëtar për Kërkim e Zhvillim:

.....,

bëhet pjesë përbërëse e kësaj Kontrate.

2. Financimi i projektit fillon më datë

Për vitin projekti do të financohet me Lekë.

Për projekte që zgjasin më shumë se një vit, fondi për vitin pasardhës jepet pasi paraqitet raporti për realizimin e detyrave të vitit paraardhës dhe është lidhur kontrata për financim vjetor sipas modelit të dhënë në Aneksin III.

Aparaturat, pajisjet dhe baza tjetër materiale e nevojshme për kryerjen e studimit, sigurohet nga pala zbatuese, sipas rregullave financiare në fuqi (për prokurim, etj.).

3. Agjencia ekzekutuese, sipas nevojave dhe specifikave që ka projekti harton metodika, plane pune mujore, etj, për realizimin e tij.

4. Në rast se gjatë kryerjes së projektit lind nevoja për të bërë ndryshime në objektivat e tij, në afatet e kryerjes së fazave të ndryshme apo të projektit në tërësi, në personelin kryesor (punonjësit shkencorë), ose për lëvizjen e fondeve nga destinacioni i caktuar, ato mund të bëhen vetëm me dijeni e miratim të organit që financon projektin (OQFP). Për këtë paraqitet kërkesë me shkrim.

* Palët, sipas specifikave të rastit, mund të heqin ose modifikojnë pikat e parashikuara në këtë model ose të shtojnë të tjera kur e shohin të nevojshme.

5. Pala zbatuese, në fund të çdo viti, për projektet që zgjasin më shumë se një vit, i raporton me shkrim organit që financon projektin për rezultatet vjetore të projektit dhe i dërgon në të njëjtën kohë planin e detajuar të punës për vitin pasardhës, sipas modelit të dhënë në Aneks III. Në raste të veçanta, kur ecuria e projektit, për arsye të ndryshme nuk është normale, raporton edhe më përpara se ky afat.

Organi që financon projektin, kur e sheh të nevojshme, bën vlerësime afatmesme dhe kontrole dhe përcakton masa për ecurinë e mëtejshme të projektit.

6. Një kopje e studimit dhe e oponentëve, menjëherë pas shqyrtimit dhe miratimit në këshillin shkencor të institutit apo fakultetit, vihet në dispozicion të organit që financon projektin, i cili organizon vlerësimin përfundimtar me grup ekspertësh, jo më vonë se dy muaj nga data e paraqitjes së materialit përfundimtar. Së bashku me studimin dorëzohet dhe situacioni përfundimtar i shpenzimeve të kryera sipas zërave.
7. Përdorimi i rezultateve dhe i informacionit të studimit nga zbatuesit do të jetë:
 - a) i lirë;
 - b) me autorizim të organit që financon projektin (në rastet kur informacioni dhe rezultatet përbëjnë vlera shtetërore dhe komerciale të veçanta).
8. Kur afati i kryerjes së studimit nuk respektohet për arsye të mosfinancimit në kohë, mban përgjegjësi organi që financon projektin, ndërsa për arsye të tjera mban përgjegjësi institucioni zbatues.
9. Kur puna e kryer nuk u përgjigjet kërkesave të kësaj kontrate, dëmin financiar të shkaktuar e shlyen institucioni që kryen studimin.

Kontrata është e vlefshme deri në fund të afatit të projektit, me përjashtim të rasteve kur, nga të dy palet, ajo shpallet e pavlefshme.

Kontrata u përpilua në dy kopje me vlerë të barabartë. Secila palë mban një kopje.

Drejtuesi i Agjencisë Ekzekutuese

Drejtori i Përgjithshëm i AKKSHI

Drejtuesi i Grupit Kërkimor

KONTRATË

Nr. ____ Prot

Tiranë, më ____/____/____

PËR FINANCIM VJETOR

Viti

Sot, më datë, në Tiranë, ndërmjet:

Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI), institucion financues, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm

dhe (Emri i Institucionit, Agjencisë Ekzekutuese) përfaqësuar nga:

.....,

në vijim të Kontratës së Përgjithshme ndërmjet palëve, lidhur më

për financimin e projektit me titull:

.....

.....

.....

, në kuadrin e Programit Kombëtar për Kërkim e Zhvillim:

.....,

lidhet kontrata me kushtet që vijnë:

Për vitin projekti do të financohet me Lekë.

Pikat e tjera të Kontratës së Përgjithshme nuk ndryshojnë.*

Drejtuesi i Agjencisë Ekzekutuese

Drejtori i Përgjithshëm i AKKSHI-së

* Palët, kur ka arsye të forta dhe në mirëkuptim, mund të ndryshojnë pika të Kontratës së Përgjithshme, t'i heqin ose t'i shtojnë asaj të tjera, duke i specifikuar të gjitha këto ndryshime në Kontratën Vjetore të rradhës.

SKEMA E RAPORTIT VJETOR

Për realizimin e detyrave dhe financimit për vitin në vazhdim dhe

Projektplanin e punës dhe financimit për vitin pasardhës

Raporti vjetor bëhet për çdo projekt më vete dhe i paraqitet organit financues në dyjavorin e parë të muajit Dhjetor të vitit në vazhdim. Ai përmban:

- I.** Raportin për realizimin e detyrave të parashikuara në planin e punës dhe financimit (Aneks IV/1).
- II.** Pasqyrën e realizimit të financimit sipas artikujve (Aneks IV/2).
- III.** Projektplanin e detajuar të punës për vitin pasardhës (Aneks IV/3).
- IV.** Projektplanin e financimit të projektit për vitin pasardhës (Aneks IV/4).
- V.** Listën e plotë të pajisjeve që kërkohet të blihen dhe të shpenzimeve të tjera kapitale për vitin (pasardhës) (Aneks IV/5).

AGJENSIA EKZEKUTUESE

RAPORT

**Për realizimin e detyrave dhe financimit për vitin
dhe**

Projektplani i punës dhe financimit për vitin

i

Projektit:

AFATI:

Numri (Kodi) i Projektit:

I. Raport për realizimin e detyrave dhe financimit për vitin.....

- Nga detyrat (aktivitetet) që përmban plani i punës për vitin janë realizuar: (jepen një për një realizimi i detyrave dhe rezultatet e arritura, të shprehura në tregues sasiorë dhe cilësorë, si dhe lidhja e tyre me objektivat dhe rezultatet e pritëshme sipas dokumentit të projektit).

Objektivi 1:...

Aktivitetet 1:...

Aktiviteti 2:.....

- Nga detyrat e parashikuara nuk janë realizuar: (jepen një për një detyrat që nuk janë realizuar dhe shkaqet e mosrealizimit).
- Detyra të tjera që janë realizuar në kuadrin e projektit, që nuk ishin parashikuar në planin vjetor.
- Një tablllo sintetike e shpenzimeve financiare dhe problemeve që mund të kenë dalë.
- Jepet numri i punonjësve shkencorë dhe i atyre ndihmës të angazhuar në projekt gjatë vitit si dhe numri muaj-njeri korrespondues (p.sh. 6 punonjës shkencorë dhe 31 muaj/njeri; 5 punonjës ndihmës dhe 22 muaj/njeri)

II. Pasqyra e realizimit të financimit për vitin

Emertimi i Agjensisë Ekzekutuese:

Titulli i projektit:

Afati:

Pasqyrë e kërkesave për financim për vitin

Nr. i artikullit	Emërtimi i artikullit	Fonde (në Mijë Lekë)				Gjithsej
		nga OQFP		nga vetë Agj. Ekz.	nga burime të tjera	
		Plan	Fakt			
230	Shpz. për rritjen e Aktiveve të Qëndrueshme të patrupëzuara 1. Studime fizibiliteti 2. Të tjera (që nuk përfshihen në studime fizibiliteti)					
231	Shpz. për rritjen e Aktiveve të Qëndrueshme të trupëzuara					
231.35	<i>Shpenzime për instalimin e rrjetit kompjuterik</i>					
231 4	Shpenzime për aparate, pajisje teknike dhe vegla pune					
231 4003	<i>Blerje pajisje që sigurojnë energji</i>					
231 4004	<i>Blerje pajisje dhe instrumenta Laboratorike</i>					
231 4005	<i>Blerje pajisje mjekësore dhe spitalore</i>					
231 4007	<i>Blerje makineri printimi dhe grafikimi</i>					
213 4010	<i>Blerje makineri e pajisje agrikuturore</i>					
231 4011	<i>Blerje makineri e pajisje për minierat</i>					
231 4016	<i>Blerje pajisje për sistemin e sigurimit</i>					
231 8	Blerje pajisjesh zyresh					
231.80	<i>Blerje orendi zyre (tavoline, skrivani, karrike, rafte librash, dollape, perde, tabela, etj.).</i>					
231.81	<i>Blerje fotokopje.</i>					
231.82	<i>Blerje kompjuteri (PC, ekrani, tastierat dhe pajisjet e tjera të nevojshme për vënien në përdorim të kompjuterit).</i>					
231.84	<i>Blerje fakse, telefon</i>					
	Totali					

Drejtuesi i Grupit Kërkimor

Përgjegjësi i Zyrës së Financës

Drejtuesi i Agjensisë Ekzekutuese

III. Plani i detajuar i punës për vitin (pasardhës)

Emërtimi i Agjensisë Ekzekutuese:

Titulli i projektit:

.....

.....

Afati:

Plani i detajuar i punës për vitin

Nr.	OBJEKTIVI DHE REZULTATI I PRITSHËM	Veprimtaritë që do të kryhen	Afati	Personi përgjegjës
1	Objektivi: <i>Rezultati:</i> <i>Rezultati:</i>	1. 2. 3. etj. 1. 2. 3. etj.		
2.	Objektivi: <i>Rezultati:</i> <i>Rezultati:</i>	1. 2. 3. etj. 1. 2. 3. etj.		

Drejtuesi i Grupit Kërkimor

Drejtuesi i Agjensisë Ekzekutuese

IV. Projektplan i financimit të projektit për vitin (pasardhës)

Emertimi i Agjencisë Ekzekutive:

Titulli i projektit:

Afati:

Pasqyrë e kërkesave për financim për vitin

Nr. i artikullit	Emërtimi i artikullit	Fonde (në Mijë Lekë)				
		nga OQFP		nga vetë Agj. Ekz.	nga burime të tjera	Gjithsej
		Plan	Fakt			
230	Shpz. për rritjen e Aktiveve të Qëndrueshme të patrupëzuara 3. Studime fizibiliteti 4. Të tjera (që nuk përfshihen në studime fizibiliteti)					
231	Shpz. për rritjen e Aktiveve të Qëndrueshme të trupëzuara					
231.35	<i>Shpenzime për instalimin e rrjetit kompjuterik</i>					
231 4	Shpenzime për aparate, pajisje teknike dhe vegla pune					
231 4003	<i>Blerje pajisje që sigurojnë energji</i>					
231 4004	<i>Blerje pajisje dhe instrumenta Laboratorike</i>					
231 4005	<i>Blerje pajisje mjekësore dhe spitalore</i>					
231 4007	<i>Blerje makineri printimi dhe grafikimi</i>					
213 4010	<i>Blerje makineri e pajisje agrikuturore</i>					
231 4011	<i>Blerje makineri e pajisje për minierat</i>					
231 4016	<i>Blerje pajisje për sistemin e sigurimit</i>					
231 8	Blerje pajisjesh zyresh					
231.80	<i>Blerje orendi zyre (tavoline, skrivani, karrike, rafte librash, dollape, perde, tabela, etj.).</i>					
231.81	<i>Blerje fotokopje.</i>					
231.82	<i>Blerje kompjuteri (PC, ekrani, tastierat dhe pajisjet e tjera të nevojshme për vënien në përdorim të kompjuterit).</i>					
231.84	<i>Blerje fakse, telefon</i>					
	Totali					

Drejtuesi i Grupit Kërkimor

Përgjegjësi i Zyrës së Financës

Drejtuesi i Agjencisë Ekzekutive

V. Lista e plotë e pajisjeve që kërkohet të blihen dhe e shpenzimeve të tjera kapitale për vitin (pasardhës)

Emërtimi i Agjencisë Ekzekutuese:

Titulli i projektit:

.....

.....

Afati:

Lista e plotë e pajisjeve që kërkohet të blihen dhe e shpenzimeve të tjera kapitale për vitin

.....

Nr.	Emërtimi	Tipi	Sasia	Njësia	Vlerësimi i shpenzimeve në Mijë Lekë
<i>Pajisje Profesionale</i>					
1.					
2.					
3.					
4.					
5.					
6.					
7.					
8.					
9.					
10.					
11.					
12.					
13.					
14.					
15.					
<i>Të tjera</i>					
1.					
2.					
3.					
4.					
5.					
Totali:					

Drejtuesi i Grupit Kërkimor

Përgjegjësi i Zyrës së Financës

Drejtuesi i Agjencisë Ekzekutuese

Fjalorth i Termave

1. **Aktualiteti**, është shkalla në të cilën arsyet, objektivat dhe ndikimi i pritshëm i një projekti është ose mbetet i vlefshëm dhe i rëndësishëm në lidhje me objektivat afatgjata ose nevojat dhe shqetësimet prioritare të kohës.
2. **Efektiviteti**, është matësi i masës në të cilën një projekt arrin objektivat e tij.
3. **Inputet**, janë mallrat, shërbimet, personeli dhe burimet financiare që jepen për një projekt, nga të cilat pritet nxjerrja e rezultateve dhe arritja e objektivave të tij.
4. **Monitorimi**, është mbikqyrja e vazhdueshme e zbatimit të një projekti. Ai synon të japë siguri se inputet, rezultatet e synuara dhe aktivitete e tjera të nevojshme vazhdojnë në përputhje me planin.
5. **Ndikimi**, është shprehja e ndryshimeve të sjella në një situatë si rezultat i zbatimit të projektit. Ai mund të vlerësohet më mirë në afate të gjata (nëpërmjet vlerësimit Ex-Post), se sa gjatë ose menjëherë pas mbarimit të projektit.
6. **Objektivat**, janë qëllimet e projektit; janë ato që përfaqësojnë gjendjen e dëshiruar që pritet të arrijë ai.
7. **Përfituesit nga projekti**, grup njerëzish dhe/ose institucionesh që përfitojnë nga projekti. Ata ndahen në:
Përfituesit direktë, që përfitojnë drejtpërdrejt nga inputet dhe aktivitetet e projektit.
Përfituesit indirektë, që përfitojnë nga zgjidhja e problemit që trajton projekti, ndonëse nuk marrin pjesë të drejtpërdrejtë në realizimin e tij.
8. **Projekt**, është një aktivitet i planifikuar që ka për qëllim arritjen e disa objektivave nëpërmjet mjeteve të specifikuara, brenda një periudhe të caktuar kohe dhe mbështetje financiare.
9. **Rezultatet (Outputet)**, janë produktet specifike që projekti pritet të nxjerrë ose të japë nga inputet, me qëllim që të arrihen objektivat e tij.
10. **Vlerësimi**, është një proces që synon të përcaktojë në mënyrë sa më sistematike dhe objektivisht rëndësinë, efektivitetin dhe ndikimin e një projekti nën dritën e objektivave të tij. Ai është një instrument drejtimi dhe një proces organizativ i nxjerrjes së mësimave dhe i orientimit drejt veprimit për përmirësimin e aktiviteteve që janë në proces, si dhe planifikimin, programimin dhe marrjen e vendimeve për të ardhmen.